



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2019:271618
Datë: 18.03.2025
Numri i dokumentit: 07005264

Ac.nr.4722/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Halide Reka, kryetare e kolegjit, Naim Mehulli dhe Besnik Bislimaj, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Xhennet Shantir, në çështjen juridike kontestimore të paditësit P.K nga Peja, rruga “Q”, nr.**, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Muharrem Shala, avokat nga Peja, kundër të paditurve P.K nga Peja, rruga “Q”, nr.**, të cilin sipas autorizimit e përfaqësojnë Mustafa Radoniqi avokat nga Peja dhe K.A.M&Partners LLC, me avokatët Durim Osmani dhe Feim Alaj nga Prishtina dhe F.K nga Peja, rruga “Q”, nr.**, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shaban Shala avokat nga Peja, me objekt të kontestit vërtetim i të drejtës së pronësisë, duke vendosur sipas ankesës së të paditurit të parë, të paraqitur kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.***/16, të datës 13.05.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 13.03.2025, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurit P.K nga Peja, rruga “Q”, nr.**, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Pejë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, C.nr.***/16, i datës 13.05.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë me aktgjykimin e ankimuar C.nr.***/16, të datës 13.05.2022, në pikën I (një) të dispozitivit ka vërtetuar se paditësi P.K nga Peja, është pronar në bazë të kontributit në bashkësinë familjare dhe pasurore i pjesës veriore të patundshmërisë e cila evidentohet si njësi

kadastrale me nr.****-*, ZK Pejë në sipërfaqe prej 323m², si dhe i pjesës jug-perëndimore të patundshmërisë e cila evidentohet si njësi kadastrale me nr.****-*, ZK Pejë në sipërfaqe prej 21m², të cilat gjendet në vendin e quajtur “K.” me kulturë shtëpi dhe oborr, kjo pjesë përbënë sipërfaqen e plotë prej 344 m² dhe realizohet nga pika 15 në kufi me ngastrën ****-* për të vazhduar në anën lindore në gjatësi prej 26,92 m deri në rrugën e përbashkët në pikën 16, për tu kthyer në drejtim të veriut kah pik 21 në gjatësi prej 7,20 m për të vazhduar në të njëjtin drejtim në gjatësi prej 6,89 m deri në pikën 22, pastaj nga kjo pikë kthehet në dertim të perëndimit në gjatësi prej 23,58 m deri në pikën 25, për tu kthyer në drejtim të jugut nëpër pikë 24 e cila është pika e trekufirit të ngastrave ****-*, ****-* dhe ****-* për të vazhduar në të njëjtin drejtim deri në pikën fillestare 15 në gjatësi prej 14,51 m.

Në pikën II (dy) të dispozitivit ka vërtetuar se paditësi P.K nga Peja, është pronar në bazë të kontributit në bashkësinë familjare dhe pasurore i pjesës jug-lindore të patundshmërisë e cila evidentohet si njësi kadastrale me nr.****-*, ZK Pejë në sipërfaqe prej 98m², si dhe i pjesës verilindore të patundshmërisë e cila evidentohet si njësi kadastrale me nr. ****-* Pejë në sipërfaqe prej 122 m² të cilat gjenden në vendin e quajtur “K.” me kulturë livadh, kjo pjesë përbënë sipërfaqen e plotë prej 220 m² dhe realizohet nga pika 19 në kufi me ngastrën kadastrale nr.***** për të vazhduar në anën perëndimore në gjatësi prej 15,51 m deri në pikën 17, për tu kthyer në drejtim të veri kah pika 20 në gjatësi prej 5,94 m, për të vazhduar në të njëjtin drejtim në gjatësi prej 5.69 m deri në pikën 23, dhe nga kjo pikë në gjatësi prej 6 m deri në pikën 28, nga pika 28 në gjatësi prej 4,89 m deri në pikën 29, dhe nga pika 29 në gjatësi prej 6,74 m deri në pikën 33, për tu kthyer në drejtim të lindjes në gjatësi prej 3,98 m deri në pikën 32, për tu kthyer në drejtim të jugut në gjatësi prej 12,67 m dhe për të vazhduar në të njëjtin drejtim në gjatës prej 6.27 m deri në trekufirin e ngastrave ****-*, ****-* dhe ****-*, për të vazhduar në drejtim të juglindjes deri në pikën fillestare 19 në gjatësi prej 8,16 m.

Në pikën III (tre) të dispozitivit i ka detyruar të paditurit P.K dhe F.K, që të dy nga Peja, që paditësit t'ia njohin të drejtën e pronësisë mbi këtë patundshmëri dhe t'ia lejojnë që e njëjta të regjistrohet në emër të tij në Regjistrin e të drejtave në patundshmëri, pranë Drejtorisë për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronësi në Pejë, në afat prej 15 dite nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi.

Në pikën IV (katër) të dispozitivit e ka detyruar të paditurin e parë P.K nga Peja, që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 4.015 €.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor i padituri i parë ka paraqitur ankesë dhe ankesë plotësuese, nëpërmes përfaqësuesve të autorizuar, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim për Gjykatën e Apelit që aktgjykimin e ankimuar ta prishë dhe çështjen ta kthejë në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Përgjigje në ankesën e të paditurit të parë ka paraqitur paditësi, nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar, me të cilën i ka kundërshtuar pretendimet ankimore të t' paditurit me propozim që ankesa të refuzohet si e pabazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar dhe komplet shkresave të lëndës, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të LPK-së, ka gjetur se:

Ankesa e të paditurit P.K nga Peja është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi me datë 15.04.2016, ka paraqitur padi në gjykatën e shkallës së parë kundër të paditurit të parë P.K, për vërtetimin e pronësisë, me arsyet sikurse në padi. Me parashtresën e datës 10.10.2018, paditësi nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar ka bërë përmisimin dhe ndryshimin subjektiv të padisë, në atë mënyrë që në cilësinë e të paditurit përfshihet edhe F.K, me kërkesë të njëjtë sikurse në padinë fillestare - vërtetimin e pronësisë. Ndërsa me parashtresën e datës 12.05.2021, paditësi nëpërmes përfaqësuesit të autorizuar, duke vepruar në bazë të aktvendimit të gjykatës së shkallës së parë C.nr.***/16, të datës 06.05.2021, bazuar në raportin dhe skicën nga vendi i ngjarjes të ekspertëve të gjeodezisë, brenda afatit ligjor ka bërë precizimin e padisë ku si palë të paditur nuk i ka përfshirë trashëgimtarët e të ndjerit P.K, por vetëm P.K dhe F.K.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e ankimuar C.nr.***/16, të datës 13.05.2022, me të cilin e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të ankimuar gjykata e shkallës së parë ka theksuar se, nga provat e administruara rezulton se pasuria lëndore, respektivisht ngastrat kadastrale nr.***/*, ***/* dhe ***/*, ZK Pejë, janë pasuri e blerë me mjetet e përbashkëta të vëllezërve P.K, P.K, P.K dhe F.K dhe prindërve të tyre Z dhe D.K , të cilët kanë kontribuar së bashku duke qenë në të njëjtën bashkësi familjare dhe pasurore, nëpërmes kursimeve të përbashkëta. Pasuria lëndore është blerë në vitin 1979, derisa ishte në jetë tani i ndjeri Z.K (babai i palëve ndërgjyqëse) dhe në kohën kur janë kryer këto shitblerje, vëllezërit e lartcekur kanë jetuar në të njëjtin bashkësi familjare pasurore së bashku me prindërit e tyre, ku një pjesë e këtyre mjeteve për blerjen e kësaj paluajtshmërie janë siguruar nga P.K, i cili ishte i punësuar në R.F. të Gjermanisë, ndërsa pjesa tjetër është siguruar nga të ardhurat personale mujore të P.Kt, F.K dhe bashkëshortes së tij Dritës, si dhe P.K, të cilët ishin të punësuar në institucione të ndryshme arsimore dhe në të njëjtën kohë janë marr edhe me prodhime bujqësore, me mirëmbajtjen e bagëtive dhe kanë punuar tulla të ashtuquajtura “qerpiq” dhe blloka të betonit, kështu që të gjithë së bashku sipas mundësive kanë kontribuar në mbajtjen e familjes së tyre dhe rritjen e pasurisë dhe me iniciativën e babait të tyre, tani të ndjerit Z.K, kjo paluajtshmëri është ndarë në 5 vende (hise), ku P i është ndarë një hise më shumë për shkak të kontributit të tij më të madh dhe për shkak se në atë kohë djali i tij ka qenë i sëmurë. Gjykata në bazë të ekspertizës së gjeodezisë ka vërtetuar faktin e pakontestueshëm, se nga e gjithë kjo paluajtshmëri e blerë në bashkësi familjare pasurore, i padituri i parë P mban në posedim pjesën më të madhe dhe më të vlefshme të saj, respektivisht 1493 m2, pasi që pjesa që i takon të njëjtit është në kufi me rrugën publike “Q.”, ndërsa i padituri

i dytë F mban 751 m², vëllai i tyre, tani i ndjerë P.K, mbante 621 m², kurse paditësi vetëm 564 m², ku një pjesë e saj në skicën e matjes është evidentuar me shkronjën “H”, në sipërfaqe prej 220 m², për shkak të konfiguracionit të pjerrët të tokës është thuajse pa vlerë. Sipas gjykatës së shkallës së parë paditësi nuk mund të trajtohet si uzurpator i kësaj paluajtshmërie, pasi që e njëjta i është përcaktuar si truall për ndërtimin e shtëpisë nga anëtarët e tjerë të bashkësisë familjare, për çka kanë qenë të pajtimit të gjithë vëllezërit Krasniqi, përfshirë edhe të paditurin e parë P.K dhe nuk ka pasur asnjë pengesë në shfrytëzimin e saj, andaj nga viti 2000 kur mbi këtë truall ka filluar ndërtimin e shtëpisë të njëjtën e mban si pronë të veten. Fakti i hyrjes në posedim të pronës është vërtetuar përmes pranimit të kërkesëpadisë nga i padituri i dytë F.K, i cili në asnjë fazë të procedurës nuk ia ka mohuar paditësit të drejtën e pronësisë në sipërfaqen e bazuar sipas marrëveshjes së arritur në mes vëllezërve për ndarjen e truallit, andaj gjykata vendosi si në pikën I (një) dhe II (dy) të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar.

Sa i përket refuzimit të kërkesës së të autorizuarit të paditurit të parë, lidhur me ndërprerjen e procedurës kontestimore për shkak se i padituri i parë P.K ka probleme shëndetësore mendore, andaj nuk është në gjendje që të merr pjesë në gjykimin e çështjes, gjykata ka arsyetuar se nuk ia fali besimin, për shkak se me rastin e daljes së gjykatës në vend kishte qenë prezent edhe i padituri P.K, i cili me bindjen e gjykatës nuk dukej se kishte ndonjë problem shëndetësor. Po ashtu, sipas gjykatës nga koha kur gjykata kishte filluar procedurën me datë 08.10.2018, e deri me datë 23.02.2022, kur shqyrtimi kryesor është shpallur i mbyllur, pala e paditur ka pasur mundësi që ndaj të paditurit P.K të zhvilloj procedurën e heqjes së zotësisë së veprimit dhe caktimit të kujdestarisë për te.

Për bazën juridike gjykata i është referuar dispozitës së nenit 326 të Ligjit mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, e datës 28.03.1974, nr.10), lidhur me nenin 20 paragrafi 1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridike - Pronësore (Gazeta Zyrtare e ish RSFJ-së, Nr.*/80), ndërsa lidhur me vendimin për shpenzimet procedurale i është referuar dispozitës së nenit 449 dhe 452 lidhur me nenin 455 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe se e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së, e po ashtu aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë as në shkelje të tjera të dispozitave të procedurës kontestimore të cilat i ka pretenduar pala ankuese me ankesë.

Pretendimi ankimor i palës ankuese se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2. pika n) të LPK-së, është pretendim tërësisht i paqëndrueshëm. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë dhe i kuptueshëm, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore duke arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet dhe si i

ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Po ashtu sipas vlerësimit të kësaj gjykate, në mes të arsyeve të paraqitura nuk ekzistojnë kundërthënie, në ndërkohë që kundërthënie nuk ka as në mes të dispozitivit dhe arsyetimit të aktgjykimit.

Nuk qëndron pretendimi ankimor i të paditurit të parë se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2. pika i) të LPK-së, ngase sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit në rastin konkret gjykata e shkallës së parë i ka dhënë mundësi të mjaftueshme palëve ndërgjyqëse gjatë tërë zhvillimit të kësaj procedure, sa i përket shqyrtimit të mjaftueshëm të çështjes së tyre, andaj me të drejtë ka vendosur kur ka refuzuar kërkesën e të autorizuarit të paditurit të parë për shtyrjen e seancës gjyqësore, me arsyetimin se i padituri i parë nuk mund të prezantojë si shkak i një kontrole neuropsikiatrike dhe ka vendosur që në mungesë të të paditurit të parë që është i thirrur rregullisht në seancë, ta mbajë seancën e caktuar, me qëllim të mbarëvajtjes së procedurës. Ky veprim i gjykatës bazohet në dispozitat ligjore, konkretisht në dispozitën e nenit 423 paragrafi 4 të LPK-së, e cila përcakton se: *“Në qoftë se në seancën për shqyrtim kryesor nuk vjen i padituri që është thirrur rregullisht, atëherë shqyrtimi kryesor i çështjes bëhet pa praninë e tij”*, rrrjedhimisht, mbi bazën e nenit të lartcekur rezulton se gjykata e shkallës së parë në rastin konkret nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim të kundërligjshëm lidhur me mosdhënien e mundësisë të paditurit të parë për shqyrtimin e çështjes në gjykatë.

Sa i përket pretendimit ankimor të palës ankuese se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilën kjo gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare, konkretisht nga neni 182 paragrafi 2. pika k) të LPK-së me pretendimin se në procedurë si i paditur ka marrë pjesë personi që nuk mund të jetë palë në procedurë, pasi që i padituri i parë gjykatës i ka ofruar prova materiale që vërtetojnë se i njëjti ka probleme mjekësore, andaj gjykata është dashur ex officio të caktoj ekspertizë psikiatrike, ngase i padituri i parë në një gjendje të tillë nuk mund të përfaqësoj veten dhe të autorizoj avokat. Sipas vlerësimit të kolegjit të kësaj gjykate, ky pretendim ankimor është tërësisht i pabazuar, për faktin se gjykata e shkallës së parë në arsyetimin e aktgjykimit të ankimuar lidhur me gjendjen mendore të të paditurit të parë ka dhënë arsye të mjaftueshme, duke theksuar se me rastin e daljes së gjykatës në vend të ngjarjes ka qenë prezent edhe i padituri i parë P.K (fakt i vërtetuar edhe me fotografitë të cilat gjykata i ka bërë në vend të cilat gjenden në shkresat e lëndës), i cili me bindjen e gjykatës nuk dukej se ta ketë humbur në tërësi aftësinë për të ndjekur gjykimin dhe për ti kuptuar pasojat e veprimeve të tij. Por edhe nëse të kishte ekzistuar një gjë e tillë, pala e paditur nga koha e fillimit të kësaj procedure e deri në mbylljen e shqyrtimit kryesor ka pasur mundësi që të zhvilloj procedurën për heqjen e zotësisë së veprimit dhe caktimit të kujdestarit ndaj të njëjtit. Në anën tjetër përfaqësuesit e autorizuar të të paditurit të parë në ankesën plotësuese kanë theksuar se i padituri i parë nuk ka aftësi të përfaqësoj veten apo të autorizoj avokatin e parë në këtë çështje juridike kontestimore, sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit shtrohet pyetja se: nëse i padituri i parë nuk ka pasur aftësi të veprimit për të përfaqësuar veten dhe për të autorizuar avokatin e parë M.R, si ekziston mundësia që të ketë aftësi për ti autorizuar të njëjtit për të parashtruar ankesën plotësuese, ngase në vet ankesën plotësuese është bashkangjitur autorizimi për përfaqësim i datës

18.05.2022, i dhënë personalisht nga i padituri i parë P.K, avokatëve Durim Osmani dhe Feim Alaj, për ta përfaqësuar në këtë çështje juridike kontestimore.

Rrjedhimisht, kjo gjykatë i vlerësoi edhe pretendimet tjera ankimore për shkelje të dispozitave procedurale, por të njëjtat i konsideron si të paqëndrueshme dhe jo relevante përkitazi me çështjen, për faktin se pretendimet e tilla janë paraqitur në mënyrë të gjeneralizuar dhe këto dispozita në të cilat është thirrur pala ankuese nuk kanë të bëjnë me çështjen konkrete, apo me ndonjë rrethanë që do të ndikonte në marrjen e ndonjë vendimi tjetër nga ajo që është vendosur në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata e Apelit i vlerëson si të paqëndrueshme pretendimet ankimore të të paditurit të parë se aktgjykimi i ankimuar është rezultat i vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, pasi që nga shkresat e lëndës rezulton se gjykata e shkallës së parë ka vendosur në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme, duke u mbështetur në provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor, të cilat i referohen gjendjes faktike të vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë, nga e cila gjendje faktike është vërtetuar se paditësi është pronar në bazë të kontributit në bashkësinë familjare dhe pasurore në pjesët e paluajtshmërisë lëndore, sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Në anën tjetër në bazë të provave të administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, i padituri i parë me asnjë provë konkrete valide nuk ka arritur të provoj faktin se paditësit nuk i takon pronësia mbi këto ngastra lëndore, duke marrë parasysh edhe faktin se, i padituri i dytë e ka pranuar kërkesëpadinë e paditësit, rrjedhimisht në bazë të kësaj është provuar se ka ekzistuar marrëveshja e arritur në mes të vëllezërve për ndarjen e paluajtshmërisë, mirëpo jo në formën e dhënë nga ligji, por vetëm gojarisht, gjë që në rastin konkret është e mjaftueshme për të provuar ekzistencën e vullnetit të palëve për ndarjen faktike të pronës lëndore dhe ky fakt ka rëndësi në mirëbesimin e mbajtjes së pronës në posedim nga ana e paditësit.

Gjykata e Apelit vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë për themelësinë e kërkesëpadiës, është i drejtë dhe i bazuar në ligj. Në rastin konkret, e në bazë të provave të administruara nga ana e gjykatës së shkallës së parë, është vërtetuar pa mëdyshje se paditësi derisa ka qenë në bashkësi familjare dhe pasurore ka kontribuar në mbajtjen e familjes dhe rritjen e pasurisë së bashku me vëllezërit e tij, ku edhe duke qenë në të njëjtën bashkësi familjare dhe pasurore, nëpërmes kursimeve të përbashkëta të tyre kanë blerë edhe pasurinë lëndore, në të cilën me të ardhurat e tij personale ka kontribuar edhe vet paditësi. Më vonë me kërkesën e të atit të tyre, tani të ndjerit Z.K, e gjithë paluajtshmëria e blerë në bashkësi familjare pasurore është ndarë në 5 vende (hise), ku pjesët e ngastrave lëndore për të cilat paditësi i është njohur e drejta e pronësisë si në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, i janë përcaktuar të njëjtit si truall për ndërtimin e shtëpisë nga anëtarët e tjerë të bashkësisë familjare, për çka kanë qenë të pajtimit të gjithë vëllezërit Krasniqi, përfshirë edhe të paditurin e parë P.K. Andaj rrjedhimisht nga viti 2000 kur paditësi mbi këtë truall ka filluar ndërtimin e shtëpisë, që nga ajo periudhë e deri tani të njëjtën e mban si pronë të veten, fakti i hyrjes në posedim të pronës dhe i ekzistimit të marrëveshjes verbale ndërmjet vëllezërve për ndarjen faktike të pronës vërtetohet edhe përmes pranimi të kërkesëpadiës nga i padituri i dytë F.K, i cili në asnjë fazë të procedurës nuk ia ka mohuar paditësit të drejtën e pronësisë në sipërfaqen e bazuar sipas marrëveshjes së arritur në mes vëllezërve për ndarjen e truallit. Andaj mbi bazën e lartcekurave, vlerësimi i provave nga

gjkata e shkallës së parë dhe përfundimi i nxjerrë nga vlerësimi i tyre përkitazi me kërkesëpadinë është i pranueshëm edhe për Gjykatën e Apelit.

Rrjedhimisht, mbi bazën e gjendjes faktike të vërtetuar, kolegji i kësaj gjykate vlerëson se nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurit të parë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka zbatuar të drejtën materiale, për arsye se gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka zbatuar dispozitat e nenit 326 të Ligjit mbi Martesën dhe Marrëdhëniet Familjare (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, nr.10, e datës 28 mars 1984) ku është përcaktuar se: *“Kur në bashkësinë familjare me bashkëshortet, përkatësisht me bashkëshortet jashtëmartesor jetojnë fëmijët e tyre dhe personat e tjerë të cilët punojnë në pasurinë bujqësore ose bashkërisht ushtrojnë veprimtari të tjera ose në ndonjë mënyrë tjetër punojnë bashkërisht, pasuria e fituar gjatë vazhdimit të asaj bashkësie është pasuri e përbashkët e të gjithë anëtarëve të bashkësisë familjare të cilët kanë marrë pjesë në fitimin e saj”*. Ky ligj ka qenë në fuqi në vitin 2000, kur paditësit i është përcaktuar trualli për ndërtimin e shtëpisë, sikurse në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, si rezultat i kontributit të tij në krijimin e kësaj pasurie përgjatë bashkësisë familjare pasurore, për çka kanë qenë të pajtimit të gjithë vëllezërit Krasniqi, përfshirë këtu edhe të paditurin e parë dhe nuk ka pasur asnjë pengesë në shfrytëzimin e saj. Në anën tjetër neni 20 paragrafi 1 i Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Juridiko Pronësore (Gazeta Zyrtare e RSFJ nr.6/80), i cili ka qenë në fuqi në kohën e krijimit të raporit juridik të pretenduar, ka përcaktuar se: *“E drejta e pronësisë fitohet sipas vetë ligjit, në bazë të veprimit juridik dhe me trashëgim.”* Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore e duke u bazuar në këtë gjendje faktike Gjykata e Apelit erdhi në përfundim se gjykata e shkallës së parë drejt ka aplikuar të drejtën materiale e cila për qëndrimin e vet ka dhënë arsye të mjaftuara, bindëse faktike dhe juridike për faktet vendimtare për vendosje përkitazi me kërkesëpadinë e paditësit.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera ankimore, mirëpo të njëjtat pretendime nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

I drejtë del të jetë vendimi mbi shpenzimet e procedurës i cili është në përputhje me dispozitën e nenit 452. 1 të LPK-së sipas së cilës dispozitë pala e cila humb procesin gjyqësor tërësisht ka për detyrë që palës kundërshtarë t’ia shpërblej të gjitha shpenzimet e procedurës kontestimore dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifatat për shpenzime gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart e në pajtim me dispozitën e nenit 194, 195 paragrafi 1 pika (d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.4722/2022, me datë 13.03.2025.

Bashkëpunëtorja profesionale
Xhennet Shantir

Kryetarja e kolegjit
Halide Reka, d.v.